7557
14.08.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

R E L A C I O N

KËSHILLIT BASHKIAK

MBI NJË SHTESË NË TRANSFERTËN E PA KUSHTËZUAR DHE RISHPËRNDARJE NË BUXHETIN E VITIT 2026 DHE PBA 2027-2029, MIRATUAR ME VKB NR.122 DATË.23.12.2025

Të nderuar Këshilltarë!

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave nr 11214/3 datë 06.07.2026 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.2 datë 30.06.2026" **si dhe shkresës së Ministrisë së Arsimit** nr 4235/11 "Njoftim për shpalljen e projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit" në Buxhetin e viti 2026 do të bëhet shtesa në **vlerën 1,276,000** lekë dhe rishpërndarje në vlerën 10,000,000 lekë në Buxhetin e vitit 2026 si dhe rishpërndarje në PBA 2027-2029 në vlerë 12,431,300 lekë si me poshte vijon:

1. Ministria e Financave me shkresën e saj nr.11214/3, datë 06.07.2026, në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", të ndryshuar ka dërguar detajimin e shtesës së fondeve për njesitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në shumën 1,276,000 lekë sipas tablës nr 3 të Aktit Normativ nr.2 datë 30.06.2026.
Sipas Vendimit nr 536 datë 09.07.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 203 datë 10.04.219, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të masës së përfitimit dhe llogaritjeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", fondi i alokuar nga Ministria e Financës si transfertë e pakushtëzuar sektoriale do të shërbej për të mbuluar shërbimet sipas VKM nr 536 datë 09.07.2026 ku sipas pikës 2, efektet financiare shtesë që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet transfertës së pakushtezuar sektoriale për bashkitë.

Nisur nga llogaritjet dhe analiza e programit, paraqesim ndarjen e këtij fondi sipas tabelës bashkëlidhur.

Institucioni	Programi	Gr	Kapitulli	Produkti	Vlera	Artikulli 600	Artikulli 601
2129001	AA129	00	01	V328AAB	1,276,000	1,093,400	182,600
Shuma Bashkia Lushnje					**1,276,000**	**1,093,400**	**182,600**

2. Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjit nr 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar, Urdhërit nr.382, datë 20.07.2026, të Ministrit të Arsimit "Për shpërndarjen e financimit për projektë të reja, me cikël financimi 2026-2028, nga programet "Arsimi Bazë" dhe "Arsimi i Mesëm" për infrastrukturën shkollore, Bashkia Lushnje është shpallur fituese për projektin "**Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "Foto Puka"** me vlerën e plotë të projektit **86,446,502 lekë** nga të cilat **69,127,202 lekë** do të financohen nga Ministria e Arsimit dhe **17,289,300 lekë** do të financohen nga Buxheti i Bashkisë Lushnje (20% e vlerës totale të projektit).
Për financimin e këtij projekti do të kryejmë një **rishpërndarje** të fondeve në Buxhetin e vitit 2026 dhe në PBA 2027-2029 pasi financimin do e shtrimë në dy vite (2026-2027) përsa i përket pjesës së bashkëfinancimit nga ana e Bashkisë Lushnje.
Bazuar në Udhëzimin Nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 100, rishpërndarja e fondeve buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore: germa a) ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; do të rishpërndajme buxhetin duke pakësuar programi AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" projektin P452AID-05-231 "Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Iljaz Ahmeti" në vlerën 10,000,000 lekë për vitin 2026 fond i cili është i lire pasi fituesi i projektit është shpallur me vlerë më të ulet. Kjo shumë do të shpërndahet për financimin e 2 (dy) projekteve të Bashkisë Lushnje. Buxhet i Bashkise Lushnje do të rishpërndahet duke pakësuar projektin P452AID në vlerën 10,000,000 lekë dhe duke shtuar projektet:

a) "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare 'Foto Puka'" në vlerën 4,858,000 lekë për vitin 2026.
Për vitin 2027 të përdoret fondi duke e pakësuar në vlerën 12,431,300 lekë nga kodi i projektit AC129-05-231- P912AAG "Rikonstruksione në kopshte dhe çerdhe", dhe duke e shtuar në programin AC129-05-231 "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Foto Puka", kod i cili do të krijohet nga nga Ministria e Financave pasi të miratohet projekti me Vendim të Këshillit Bashkiak, dhe
b) "Rikontruksion i godinës dhe palestrës 'Jani Nushu'" në vlerën 5,142,000 lekë për likujdimin e detyrimt për projektin P923AAI-05-231. Investimi për këtë projekt ka përfunduar por bazuar në kontratë kjo shumë duhet të ishte alokuar nga Ministria e Arsimit, në vijimësi të korespondencës me Ministrinë e Arsimit e cila nëpermjet shkresës nr 3213/3 datë 03.07.2026 shprehet se Bashkia Lushnje duhet të marrë përsiper likujdimin e pjesës së mbetur të palikujduar, si pjese e bashkëfinancimit të projektit, financimi i vlerës së mbetur të likujdohet nga buxheti i vetë aplikuesit /autoritetit kontraktor.

Për këtë kërkojmë të **rishpërndarje në buxhetin** e vitit 2026 dhe PBA e viti 2027-2029 në zerat e mëposhtëm për investimet:

Rishpërndarje në buxhetin e vitit 2026:

I. Pakësohet:

Bashkia Lushnje (për vitin 2026)

Grupi	Tit (Prog)	Kapit	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit
00	AB129	05	231	10,000,000 lekë	P452AID

II. Shtohet:

Bashkia Lushnje (për vitin 2026)

Grupi	Tit (Prog)	Kapit	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit
00	AC129	05	231	4,858,000 lekë	(Kod i ri, Shkolla F.Puka)
00	AC129	05	231	5,142,000 lekë	P923AAI

Rishpërndarje në PBA 2027-2029:

I. Pakësohet:

Qendra e Arsimit (per vitin 2027)

Grupi	Tit (Prog)	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit
00	AC129	231	12,431,300 lekë	P912AAG

II. Shtohet:

Bashkia Lushnje (per vitin 2027)

Grupi	Tit (Prog)	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit
00	AC129	231	12,431,300 lekë	(Kod i ri, Shkolla F.Puka)

Theksojmë së ndryshimet midis Programeve kërkojnë miratimim nga Këshilli Bashkiak sipas Udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018, pika 100 gërma a.

Ju faleminderit!

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Juljana Hasalla

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Erisa Qalliu

Për Drejtorinë e Financë–Buxhetit

Ervisa Çuko

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 7957/1 Prot

Lushnje, më 14.08.2026

PROJEKT VENDIM

Nr 68 Datë 14 .08.2026

MBI NJË SHTESË NË TRANSFERTËN E PA KUSHTËZUAR DHE RISHPËRNDARJE NË BUXHETIN E VITIT 2026 DHE PBA 2027-2029, MIRATUAR ME VKB NR.122 DATË.23.12.2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.08.2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur "Mbi një shtesë në transfertën e pakushtëzuar dhe rishpërndarje në Buxhetin e vitit 2026 dhe PBA 2027-2029, miratuar me VKB nr.122 datë.23.12.2025", si dhe në Zbatim të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore, neni 54, Ligjit nr.68/ 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 45, neni 23 paragrafi 'Transferta e pakushtëzuar", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat Standarte të zbatimit të buxhetit" pika 100 gërma a, të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2026", dhe ligjit nr Ligjin Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", si dhe në shkresën e dërguar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore me nr.11214/3, datë 06.07.2026 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.2 date 30.06.2026" si dhe shkresës së Ministrisë së Arsimit nr 4235/11 "Njoftim për shpalljen e projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit"

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë shtesën e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026 me 1,276,000 lekë. (Si pjesë e transfertës së pakushtëzuar sektoriale) sipas tabelës.

Institucioni	Programi	Gr	Kapitulli	Produkti	Vlera	Artikulli 600	Artikulli 601
2129001	AA129	00	01	V328AAB	1,276,000	1,093,400	182,600
Shuma Bashkia Lushnje					**1,276,000**	**1,093,400**	**182,600**

2. Të miratojë rishpërndarjen në Buxhetin e vitit 2026 dhe PBA 2027-2029, miratuar me vkb nr.122 datë.23.12.2025 si më poshtë:

Rishpërndarje në buxhetin e vitit 2026:

I. Pakësohet:

Bashkia Lushnje (per vitin 2026)

Grupi	Tit (Prog)	Kapit	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit
00	AB129	05	231	10,000,000 lekë	P452AID

II. Shtohet:

Bashkia Lushnje (për vitin 2026)

Grupi	Tit (Prog)	Kapit	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit (Kod i ri, Shkolla F.Puka)
00	AC129	05	231	4,858,000 lekë	P923AAI
00	AC129	05	231	5,142,000 lekë	

Rishpërndarje në PBA 2027-2029:

I. Pakësohet:

Qendra e Arsimit (për vitin 2027)

Grupi	Tit (Prog)	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit
00	AC129	231	12,431,300 lekë	P912AAG

II. Shtohet:

Bashkia Lushnje (për vitin 2027)

Grupi	Tit (Prog)	Artikulli	Plani Vjetor	Kodi Produktit (Kod i ri, Shkolla F.Puka)
00	AC129	231	12,431,300 lekë	

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Zyra e prokurimeve.
4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Për Drejtorinë e Financë–Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE